

Dr. Vehbetu Zuhejli

Istis'habi (Ligji gravitues)

Përktheu: Dr. Musli Vërbani

Kaçanik, 2018

Istis'habi

Për istis'habin do të flasim si në vijim:

- Definicioni;
- Format;
- Analiza e mospajtimit;
- Mendimet e dijetarëve në argumentimin e tij;
- Rregullat e rezultuara mbi të.

Definicioni i istis'habit

Gjuhësisht, istis'hab do të thotë: Të kërkossh shoqërim.

Te ushuljinët istis'hab është: **Ligj për të ligjësuar një çështje apo për ta mohuar atë për të tashmen ose për të ardhmen, duke e marrë për bazë ligjësimin apo mohimin në kohën e kaluar, për shkak të mosekzistimit të ndonjë argumenti për ndryshim.** Shembull: Nëse thuhet, gjykimi për filanin, ka qenë dhe nuk mendoj se është hequr, dhe çdo gjë që dihet, dihet siç ka qenë. Kjo është se mendohet të jetë siç ka qenë sepse mendimi është argument mbështetës në dispozitim siç është rasti i shafijve se, të dalurit diçka, nga përpos dy organeve nuk e prish abdesin, pasi që një person ka qenë me abdes para daljes (së diçkaje). **Kjo është unanime, çka ka qenë mbetet siç ka qenë.**

Ibn Hazmi e ka definuar kështu: **Të mbeturit e ligjit bazë e ligjësuar me tekste derisa të ketë argument për ndryshimin e tij.** Ibn Hazmi istis'habin e kushtëzon që të jetë i ligjësuar prej tekstit dhe jo prej ligjit bazë i cili është prej ligjit bazik esencial të lejimit.

Vërehet se me istis'habin vjen në pyetje të veprohet atëherë kur nuk ka argument tjetër.

Havarizmiju në librin “El-Kafij” thotë: **Istis'habi është faza e fundit e fetvasë.** Nëse muftiu pyetet për një çështje, e kërkon dispozitën e asaj çështjeje në Kur'an, pastaj në sunet, pastaj në ixhmaë, pastaj në kijasë, nëse nuk e gjen përgjigjen në këto argumente atëherë e shikon dispozitën e saj në istis'habin momental të mohimit të asaj çështjeje apo vërtetimit të saj:

- Nëse hamendet se nuk është anuluar, atëherë bazike është që të mbetet ajo çështje siç është.

- Nëse hamendet se është vërtetuar, atëherë bazike është të mos vendoset ajo çështje.

Shembull: Te femra, bazike është virgjëria e saj, derisa nuk vërtetohet me dëshmi se është e vejë.

Në pronësi, bazike është pronësia derisa të mos vërtetohet heqja prej asaj pronësie, pra, deri sa të vërtetohet e kundërta.

Në vepra, esenciale është pafajësia.

Nga kjo shihet qartë se dijetarët janë pajtuar se istis'habi nuk është argument për çështjet e prera të akaidit (besimit) si f.v., pejgamberia e Muhamedit a.s.

Po ashtu dijetarët janë pajtuar se nuk lejohet të argumentuarit me istis'hab në atë çka është vërtetuar apo është mohuar me argument sheriativ sepse ajo veç është ndryshuar dhe ka dalë prej kornizës së istis'habit.

Format e istis'habit

Ekzistojnë pesë forma apo pesë lloje të istis'habit, e ata janë:

E para: istis'habi i dispozitës së lejimit bazik të çështjeve të cilat sheriatu nuk i ka ndaluar.

Koncepti i kësaj është se, shumica absolute e dijetarëve të usulit kanë miratuar vendimin se pas ardhjes së sheriatit, në çështjet e dobishme për të cilat nuk ka dispozitë të caktuar, esenciale është lejimi, ashtu siç në çështjet e dëmshme esenciale është ndalesa.

Argumenti i dytë, thënia e pejgamberit s.a.v.s.: **“Mos dëmtoni dhe mos u dëmtoni në islam.”**

Kjo do të thotë se absolutisht nuk lejohet dëmi sepse e papërcaktuara në formulimin e mohimit është rregull i përgjithshëm. Kur mohohet e lejuara vërtetohet e ndaluara dhe kjo është ajo që kërkohet.

Argumentimi i të parës me tre ajete në vijim.

a. Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

هُوَ الَّذِي خَلَقَ لَكُمْ مَّا فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا

“Ai (All-llahu) është që për juve krijoi çka ka në tokë,.” (El-Bekare : 29)

Zoti i Lartmadhëruar na ka treguar se të gjitha krijesat e tokës janë për njeriun sepse pjesëza “**çka**” nënkupton përgjithësimin, posaçërisht kur përforcohet edhe me fjalën “**në përgjithësi**”.

Pjesëza “**për**” ka kuptimin e specifikimit për dobi, që do të thotë se, çdo gjë që është në tokë është posaçërisht për t’ju sjell dobi juve dhe ajo dobi e cila realizohet nga të gjitha krijesat, për të ligjërisht është lejimi.

b. Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

قُلْ مَنْ حَرَّمَ زِينَةَ اللَّهِ الَّتِي أَخْرَجَ لِعِبَادِهِ وَالطَّيِّبَاتِ مِنَ الرِّزْقِ

“**Thuaj: - Kush i ndaloj bukuritë dhe ushqimet e mira që All-llahu i krijoi për robërit e vet...**” (El-Earaf : 32)

Forma pyetëse tregon për mohim dhe do të thotë se Zoti i Lartmadhëruar nuk e pëlqen ndalimin e bukurive të cilat janë të specifikuar që t’i shfrytëzoj për dobi, ashtu siç kuptohet prej pjesëzës “për” e cila përcakton specifikimin në thënien e Zotit të Lartmadhëruar “për robërit e tij” (لِعِبَادِهِ).

c. Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

أُحِلَّ لَكُمْ الطَّيِّبَاتُ

“**Për ju janë të lejuara mirësitë.**” (El-Maide : 4)

Pjesëza “**për**” te pjesa e tekstit “**për ju**” tregon se të mirat janë posaçërisht për ne, për t’i shfrytëzuar *siç i sqaruar më parë*.

Fjala “**mirësitë**” nuk është për qëllim “**lejimi**” sepse do të duhej të përsëritej kuptimi por qëllimi është “atë të cilën shpirti e llogaritë për të mirë”.

Këto ajete tregojnë se, esenciale çështjet janë të lejuara deri sa të sillen argument për ndalimin e tyre, kështu që çdo lloj ushqimi, pije, veshje, e cila nuk ndalohet me shariat është i lejuar.

Nëse fekihi pyetet për dispozitën e prodhimeve në botë dhe nuk gjen argument shariativ i cili tregon për atë dispozitë atëherë dispozita e saj është lejimi duke u bazuar në atë se: **esenciale e çështjeve është lejimi**.

Sa i përket këtij lloji të istis’habit, tek dijetarët nuk ka divergjenca vetëm se vërehet se kjo dispozitë te usulijnët thuhet se bazën e ka te logjika, ndërsa te Ibn Hazmi, bazën e ka te teksti i përgjithshëm shariatik, që do të

thotë se çështja është neutrale derisa të mos sillet argument për ndalesën apo obligimin.

E dyta: Istis'habi i tekstit derisa nuk sillet specifikimi. Istis'habi i tekstit derisa të shfuqizohet ai tekst. Për këtë lloj nuk ka divergjenca në mes dijetarëve.

E treta: Istis'habi i një çështjeje për të cilën logjika dhe ligji tregon për ligjësimin dhe vazhdimësinë e përgjithmonshme të saj. Këtë e ka shpreh Ibn Kajimi, pra për istis'habin me cilësi të caktuar i cili istis'hab është konfirmuar me ligj, përderisa nuk vërtetohet e kundërta, si f.v., pronësia e pronarit kur të gjendet shkaku i asaj pronësie e ajo është kontrata, ajo mbetet e plotfuqishme derisa të mos gjendet diçka e cila e shpronëson atë, sikurse:

- detyra për larje të borxhit, kur ta ketë obligim,
- ose që e ka prishur atë (obligim)
- ose lejimi i kontaktimit intim me gruan e martuar për shkak të kurorëzimit,
- ose të mbeturit me abdes pas marrjes së abdesit, për këtë arsye dyshimi i prishjes së atij abdesi nuk sjell kurrfarë efekti (se është prishur), për shkak të ligjit të istis'habit të pastërtisë së (abdesit) mëhershme.

Të gjitha këto situata edhe pse nuk janë ligje prej bazës fillestare, ligji shariatik tregon për ligjësimin dhe vazhdimësinë e tyre në përgjithësi, po të mos i kishte fuqizuar ligji për vazhdimësinë vlefshmërisë së tyre, atëherë nuk do të ishte lejuar istis'habi.

Gazaliu thotë se, **istis'habi nuk është argument përpos nëse tregohet me dëshmi për ligjësimin dhe vazhdueshmërinë e tij, me kusht që të mos ndryshohet.** Në realitet kjo shprehje ka të bëjë me të përmbajturin e argumentit logjik apo shariatik (**që nënkupton çka ligjësohet fillimisht mbetet e mëtutjeshme**) dhe nuk ka të bëjë me kthimin mbrapa se nuk ka bazë juridike dhe nuk dihet ky rast në këtë kohë, por te argumenti dhe të gjeturit e bazës juridike duke e mohuar të ndryshohet ose me mendimin e mohimit të ndryshimit të ligjit pas një angazhimi të mundimshëm dhe hulumtimi për të kërkuar argumentin ndryshues.

Sipas mendimit të Ibn Kajimit, dijetarët janë të pajtimit se me këtë lloj të istis'habit duhet të veprohet derisa të gjendet ndonjë argument i cili e dëshmon të kundërtën.

Disa kanë përmendur mendime të kundërshtimit të këtij lloji të istis'habit. Kjo është më se e vërtetë. Është thënë: Ky lloj i istis'habit absolutisht nuk është argument.

Është thënë: **Është argument për të anuluar, e jo për të vërtetuar**, që do të thotë se është argument për të mbetur çka ka qenë, e jo për të vërtetuar çështjen e cila nuk ka qenë. Të këtij mendimi janë hanefijtë. Imam Maliku i ka kundërshtuar disa shembuj të këtij lloji për shkak të ekzistimit kundërthënës në mes të dy bazave juridike. Nuk lejohet namazi me dyshim të abdesit. Është ligjore shkurorezimi i trehershëm nëse burri dyshon a e ka shkurorezuar një herë apo tre herë.

E katërta: Istis'habi i pabazës fillestare – logjikisht dihet se në dispozitat e sheriatit, në të drejtën tonë janë të papranuar dispozitat para ardhjes së sheriatit si f.v., lirim i nga obligimet e sheriatit dhe të drejtave të cilat rezultojnë prej saj derisa të gjendet argument i sheriatit i cili dëshmon për ato obligime. Kjo do të thotë se ky lloj i istis'habit është vetëm ligj logjik i cili tregon se çështjet mbeten siç kanë qenë derisa të mos sillen dispozita ligjore.

Nëse një person pretendon se tjetri i ka borxh, ai duhet të sjell dëshmi se i akuzuari i ka borxh, nëse nuk mund ta vërtetojë me dëshmi, personi tjetër shpallet i pafajshëm sepse **esenciale është pafajësia derisa akuzuesi të mos sjell dëshmi se i ka dhënë borxh.**

Në esencë ligjet e sheriatit nuk janë obligim, por kur Ligjvënësi na obligon faljen e pesë kohëve të namazit, thënia për obligueshmërinë e namazit të gjashtë është në kundërshtim me bazën juridike të pesë kohëve të namazit, atëherë atij personi i kërkohet dëshmi.

Po ashtu kur Ligjvënësi na obligon agjërimin e muajit ramazan, dhe nëse një person paraqitet dhe thotë se duhet të agjërohet muaji sheval, thënia e tij është në kundërshtim me bazën, atëherë kërkohet dëshmi prej tij.

Përderisa nuk dimë argument i cili argumenton në kundërshtim me bazën juridike, konsiderohet deklaram (dituri) i pa argumentuar dhe jo çështje se nuk kemi dituri për argumentim sepse mosgjethja e argumentit

dëgjimor i transmetuar nga Ligjvënësi llogaritet dituri bindëse, e ndonjëherë mund të jetë paramenduese.

Te rasti i agjërimit dhe namazit është mosparaqitja e argumentit dëgjimor bindës sepse po të ekzistonte argumenti do të ishte përhapur masovikisht dhe do të na ishte raportuar dhe nuk do të kishte pasur mundësi të fshihej nga i gjithë umeti. Kjo është dituria e mosekzistimit të argumentit.

Përderisa, paramendimi i mosekzistimit të argumentit. Nëse muxhtehidi hulumton për argumentin por nuk e gjen atë, mbizotëron mendimi i mosekzistimit të argumentit dhe kjo do të zbriste në nivelin e ditorisë se nuk ka argumentim për të vepruar sepse ai mendon në mbështetje të hulumtimit dhe kjo është maksimalja që duhet për muxhtehidin.

Për këtë lloj të istis'habit hanefijtë thonë, **istis'habi në këtë lloj është i vlefshëm për të anuluar dhe jo për të miratuar (mbetur) siç ka qenë, siç do ta sqarojmë më vonë.**

E pesta: Istis'habi, dispozita e të cilit është rezultuar prej ixhmait.

Ky lloj i Istis'habit është bosht debati në mes të dijetarëve, ashtu që muxhtehidët janë pajtuar për realizimin e prodhimit të dispozitës së tij, mirëpo pastaj ka ndryshuar atributi i dispozitës për të cilën janë pajtuar dhe kundërshtohen për të.

Shembull i saj: **Është themeluar ixhmai për vlefshmërinë e zëvendësuesit të ujit kur mungon uji**, nëse falësi me tejemum e përfundon namazin para se të shohë ujin, namazi i tij është i rregullt dhe i vlefshëm. Mirëpo parashtrohet pyetja se nëse e sheh ujin gjatë faljes së namazit, a i priset namazi dhe a nevojitet të ripërsëritë namazin me abdes apo jo?

Shafiiu dhe Maliku thonë se namazi nuk priset sepse është themeluar ixhmai për vlefshmërinë e namazit deri para se ta shoh ujin. Kështu, rregulli i istis'habit të ixhmait është në fuqi deri sa të dëshmohet me argument se i priset namazi që në momentin kur ta shoh ujin sepse argumenti dëshmon për vlefshmërinë e ligjit të ligjësimit të atij namazi për vazhdimësinë e vlefshmërisë derisa të silltet argument i cili e dëshmon ndërprerjen e vlefshmërisë së namazit.

Ebu Hanife dhe tjerët të cilët nuk e pranojnë këtë mendim thonë se: Namazi priset dhe nuk merret parasysh themelimi i ixhmait për vlefshmërinë e namazit deri para se të shihet uji sepse ixhmai është

themeluar për mungesë të ujit dhe jo të ekzistimit të ujit. Ai i cili dëshiron ta sjell inekzistenten e të ekzistuarit ai duhet të sjell argument të ri.

Po ashtu, shembull tjetër, dhahirijtë thonë se lejohet blerja e nënës së djalit sepse është themeluar ixhmai për lejimin e blerjes së robërshës para se të lindë fëmijë te pronari i saj. Kështu dispozita e ixhmait vazhdon edhe pas lindjes së fëmijës së saj, në bazë të ixhmait paraprak sepse lindja e fëmijës nuk e ka zhvlerësuar themelimin e ixhmait.

Ky lloj i istis'habit është lloj për të cilën dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme:

Shumica e dijetarëve hanefijë dhe hanbelijë dhe shumica absolute e malikijve thonë se nuk lejohet argumentimi me vetëm ligjin e istis'habit, por nëse paraqitet kijasi apo ligj tjetër i cili e transformon prej asaj çka ka qenë më herët, atëherë transformohet, përndryshe ligji i istis'habit mbetet siç ka qenë sepse themelimi i ixhmait për një atribut të një ligji nuk e bën të patjetërsueshme themelimin e ixhmait për atributin e gjendjes tjetër, pasi që në këtë rast ixhmai është themeluar për atributin e ligjit për të cilin nuk ka qenë bosht i temës, e ai bosht i temës ka qenë vlefshmëria e namazit para se të shihet uji në namaz, ndërsa pasi që të shihet uji, më tej nuk ka themelim të ixhmait. Këtu nuk kemi ligj të istis'habit siç thotë Ibn Kajimi sepse kusht i istis'habit është të mbeturit e gjendjes në cilësinë (atributin) e kohës së dispozitës. Kjo është formula e cila merret parasysh. Nëse ndryshon atributi, atëherë ka ndryshuar gjendja, me fjalë tjera ka ndryshuar edhe pozita për t'u ligjësuar dispozita dhe çështja është se duhet t'i nënshtrohet dispozitës tjetër.

Shafijju, Ebu Thevriju, Dhahiriju, e ka parapëlqyer Amediu, Ibni Haxhibi dhe Shevkaniju shkojnë në drejtimin e argumentimit me të sepse vazhdimësia e istis'habit mbetet në pikën fillestare dhe nuk duhet të anashkalohet, përpos me argument me të cilin lejohet të ndryshohet.

Kjo, dhe... edhe nëse e pranojmë se nuk ka ixhmaë në boshtin e temës, por janë mbetur në ligjin e istis'habit për të cilin është themeluar ixhmai deri sa të anulohet ai ixhmaë dhe pastaj në rend të parë duhet të ndryshohet baza për të cilën është themeluar ixhmai, siç është rasti me ndryshimin e kohës, vendit dhe personit. Ndryshimi i vet çështjes nuk është pengesë që të mbetet ajo që është themeluar para ndryshimit, gjë që tregon se ndryshimi i atributit nuk është pengesë për të vepruar me istis'habin, deri sa të sillët argument se Ligjvënësi atë atribut e ka bërë që të transferohet nga ajo dispozitë për të gjykuar të kundërtën më pastaj. Prej shembujve të argumentit transformues:

- Terja e lëkurës është transformim i dispozitës së papastërtisë së lëkurës në pastërti.

- Thartimi (uthullimi) i alkoolit e transformon dispozitën e ndalesës (në lejesë).

Përderisa sa i përket para tharjes dhe para uthullimit (thartimit) papastërtia është permanente, po ashtu edhe ndalesa është permanente.

Kjo dhe disa dijetarë llojin e parë dhe të katërtën e kanë bashkuar në një lloj sepse lejimi bazik përfshinë istis'habin e jobazës dhe e kanë shtuar formën e pestë, e ajo quhet, istis'habi i kundërt. Ky istis'hab, ligjësimi i çështjes në kohën e kaluar duke u bazuar në kohën e tanishme deri sa të mos vërtetohet e kundërta. Malikijë, këtë lloj e mbështesin në institucionin e vakfit i cili nuk dihet, pas hulumtimit të bazës së investimit të saj dhe kushteve të vakëflënësit të saj edhe pse në të tanishmen investohet për një qëllim të caktuar, gjykohet me istis'habin e gjendjes së tashme, pasi ashtu ka qenë në të kaluarën deri sa të mos dëshmohet e kundërta. Nga kjo rezulton se format e istis'habit janë pesë:

1. Esenciale është pafajësia.

2. Istis'habi i tekstit deri sa të mos sillet diçka çka e kundërshton dhe istis'habi gjeneral derisa të mos sillet specifikimi i saj.

3. Istis'habi i atributit ligjërisht derisa të mos sillet diçka që e ndryshon atë.

4. Istis'habi i gjendjes së ixhmait, për të cilën ka divergjencë.

5. Istis'habi i të tanishmes prej së kaluarës (istis'habi i kundërt).

Mendimet e dijetarëve për argumentimin e istis'habit

Kur nuk ka argument, dijetarët për argumentimin e ixhmait janë ndarë në tri drejtime:

Drejtimi i parë: Mendimi i shumicës së mutekeliminëve. Në esencë nuk është argument sepse ligjësimi i kohës fillestare duhet të ketë argumentim, po ashtu edhe pas kohës fillestare në fazën e dytë sepse kërkohet që aty të ketë argumentim sepse në të kundërtën te ata do të ishte posaçërisht për ligjësimë, përderisa në çështjet konkrete, Zoti i

Lartmadhëruar e ka paraparë ligjin e istis'habit dhe zakonisht nuk është në ligjësi.

Drejtimi i dytë: Shumica absolute e dijetarëve hanefijë të mëvonshëm mendojnë se istis'habi është argumentim për mohim dhe anulim dhe jo për vërtetim dhe aprovim. Kjo nënkupton se vlen për të mohuar çka nuk është e vërtetuar dhe jo për ta vërtetuar atë. Istis'habi vlen për ta mohuar atë i cili pretendon ndryshimin e gjendjes (faktike) që çështja të mbetet siç ka qenë, që do të thotë se ka qenë e ligjësuar më herët dhe jo për shkak se e kërkon ligji i përfutur dhe nuk ligjësohet ligj i ri, por vazhdon ligji të jetë i vazhdueshëm në lejinin esencial apo pafajësisë, ose me të mbeturit e dispozitës së diçkaje duke u bazuar në realizimin e shkakut, me të cilën ndërlihet ajo dispozitë dhe të mbeturit e çështjes siç ka qenë. Mbështetja bëhet në obligueshmërinë e dispozitës dhe jo në mosndryshimin e saj. Për këtë arsye kanë thënë: Istis'habi është argument për të mbetur ajo çka ka qenë siç ka qenë dhe jo për të ligjësuar atë e cila nuk ka qenë: Kjo vërehet qartë në formën e tretë dhe të katërt prej formave të istis'habit.

Istis'habi i pafajësisë nuk është argument për të mbrojtur të drejtën, por vlen vetëm për ta mënjeluar kundërshtarin i cili pretendon se është e drejtë e tij pa pasur argument për ta vërtetuar pretendimin e tij. Istis'habi i pronësisë vërtetohet me aktin paraprak dhe nuk është argument për të mbetur pronësia, por argument për t'i mënjeluar pretendimet e atij i cili pretendon shpronësimin e asaj prone, pa sjellë argument për të.

Drejtimi i tretë: Mendimi i shumicës absolute të malikijëve, shafijëve, hanbelijëve dhe dhahirijëve, se istis'habi është argument për ta konfirmuar dispozitën e ligjësuar deri sa të gjendet argument për ndryshimin e tij. Vlen për ta vërtetuar ashtu siç vlen për ta mënjeluar, që do të thotë se, istis'habi i gjendjes së tanishme vërteton dy të drejta, të drejtat pozitive dhe negative, përderisa nuk sillet argument i cili ndalon vazhdimësinë. Të këtij drejtimi janë shiitët.

Nga kjo divergjencë në mes të dijetarëve rezultojnë efektet juridike në çështje si në vijim:

Gjendja e të pagjeturit (ai i cili humb nga qyteti, aq sa nuk mund të gjenden gjurmë prej tij) dhe kalon një kohë e gjatë dhe nuk gjendet asnjë gjurmë prej tij. Te malikijtë, te shafijët dhe te ata të cilët janë të të njëjtit mendim, ai ka të drejta pozitive nga të tjerët: të trashëgoj nga të tjerët ashtu që t'i rezervohet hisja e tij, i zbatohen testamentet, duke marrë parasysh se ai mund të jetë gjallë në bazë të ligjit të istis'habit. Dhe mbetet pronar i të

drejtave të tij të cilat kanë qenë para se të zhduket dhe kjo është ajo ana negative dhe këto gjykojnë për mbetjen e jetës së tij deri sa të vërtetohet vdekja e tij sepse bazë e tij është gjallëria e tij dhe merret për bazë istis'habi i bazës (gjallërisë) deri sa të vërtetohet e kundërta. Ai trashëgon por nuk trashëgohet. Hanbelijtë deklarojnë se ai trashëgohet dhe nuk trashëgon pasi që të kalojnë katër vite prej zhdukjes së tij.

Përderisa te hanefijtë, nuk i zbatohen të drejtat pozitive, si f.v., trashëgimia dhe testamenti nga tjetri, por i rezervohen vetëm të drejtat negative. I mbetet pronësia e tij, çka ka qenë para zhdukjes. Ligji i istis'habit të tij rezulton vetëm që të jepet prej tij çka rezulton prej vdekjes për t'iu ndarë pasuria e tij trashëgimtarëve, ndarja prej bashkëshortes dhe nuk rezulton që pasuria e tjerëve t'i kalon atij. Kështu ata (hanefijtë) gjykojnë në mbetjen e jetës së tij gjatë kohës së zhdukjes vetëm sa i përket pasurisë dhe bashkëshortes së tij derisa të paraqitet argument për vdekjen e tij ose që gjykatësi të shpallë vdekjen e tij.

Te ata (hanefijtë) i zhdukuri është gjallë për veten e tij, ndërsa i vdekur për të tjerët, as nuk trashëgon prej tjerëve dhe as nuk trashëgohet, nuk i rezervohet hisja e tij dhe nuk lejohet që të shpërndahet pasuria e tij te trashëgimtarët e të vdekurit sepse te ata (hanefijtë) istis'habi nuk vlen si argument për të prodhuar të drejta të reja përfituese, që do të thotë se është argument për të mënjnuar të drejtat, sa që pasuria e tij nuk trashëgohet dhe nuk vlen për të përfituar të drejtat kështu që nëse një i afërm i tij vdes, i zhdukuri nuk trashëgon, nga mundësia se ai mund të ketë vdekur.

Shafijtë dhe ata të cilët i pasojnë, argumentohen për argumentimin e istis'habit me dy argumente:

1. Ajo çka themelohet fillimisht për ekzistimin apo mosekzistimin dhe nuk paraqitet e kundërta as në mënyrë të prerë dhe as të dyshimtë logjikisht dhe detyrimisht duhet të gjykohet ashtu siç ka qenë fillimisht, të vepruarit ashtu me atë mundësi është obligim edhe nëse nuk na është raportuar do t'i kishim tri çështje të pavlefshme:

E para: Që të mos jetë ligjësuar si ligj shariativ për ne në kohën e pejgamberit s.a.v.s. me mundësi të lejimit të shfuqizimit të atij ligji sepse nëse nuk na është realizuar mendimi për istis'habin (e atij ligji) ekzistimi i atij ligji është i barabartë me shfuqizimin e saj, atëherë nuk mund të themi se patjetër duhet të jetë vetëm ashtu sepse atëherë do t'i jepnim prioritet pa të drejtë prioriteti. Vërehet se argumenti i ligjësimit të atyre ligjeve për kohën tonë është bindja se duhet të vazhdohet të mbeten siç kanë qenë dhe

ky është ligji i istis'habit, me fjalë tjera, po të mos kishte qenë istis'habi argument nuk do të kishim qenë kategorik në zbatimin e ligjit por me mundësi të shfuqizimit të tyre, por ligji i dytë do të ishte i pavlefshëm kështu që bëhet i pavlefshëm ligji i mëhershëm dhe ligjësohet e kundërta e saj.

E dyta: Që faktikisht të mos cilësohet si muëxhize sepse muëxhiza është çështje mbinatyrore e cila nuk kërkon që të mbetet e natyrshme në vazhdim sepse nëse nuk qëndron të vazhdoj e natyrshme, atëherë do të lejohej që të ndryshoj dhe muëxhiza nuk do të ishte mrekulli mbinatyrore. Vazhdimësia e gjendjes së natyrshme nënkupton që baza të mbetet ashtu siç ka qenë sepse e zakonishtja dhe natyrorja nuk do të kishte kuptim ndryshe, pos që ndodhia e një ngjarjeje të përsëritet në mënyrë të veçantë, ashtu që të krijohet bindja se nëse ndodhë, ndodhë vetëm në atë mënyrë.

E treta: Që dyshimi në shkurorezim të jetë i njëjtë sikurse dyshimi në kurorëzim, për shkak të situatës së përbashkët të tyre që të mos krijohet përshtypja në atë që ka kaluar sepse ashtu do të lejohej kontakti seksual në gjendjet e tyre, ose ndalesa e kontaktit seksual në gjendjet e tyre, sepse të gjithë janë të pajtimit se kjo është e pavlefshme por lejohet (tolerohet) kontakti seksual nëse është kryer, duke menduar se e ka pasur të lejuar (edhe pse e ka të ndaluar) dhe nuk lejohet kontakti seksual nëse kryhet duke menduar se është martuar.

2. Ekzistenca e të qenurit ka përparësi ndaj të paqenurit, kjo nga shkaku se ka prioritet ndaj të paqenurës. Për këtë të gjithë janë pajtuar se duhet të veprohet.

Sa i përket çështjes së të paqenurës, duhet ditur se e paqenura për të pasur prioritet ka nevojë për shkaktarë të ri që të ndodhë, për këtë arsye e qena ka përparësi ndaj të paqenurës. Pasi që edhe dihet qëndrimi se prioritarja ka prioritet ndaj joprioritarës.

3. Është themeluar ixhmai në bazë të istis'habit në shumë çështje sekondare të fikhut, si f.v: vlefshmëria (mosprishja) e abdesit, papastërtia, pronësia, bashkëshortësia edhe pse dyshon hamendësia e pavlefshmërisë së tyre.

Kjo dhe... Profesori Muhamed Tekijul Hakijm dijetar shiitë e ka lejuar ndodhjen e istis'habit duke e pasur parasysh në kuptim, siç e thamë më herët

dhe e ka konsideruar si dukuri të rëndomtë në shoqërinë e tyre, qoftë edhe me hamendje, e cila paraqitet instiktivisht ashtu siç ndodhin dukuritë shoqërore, ai thotë: Ajo siç e mendoj unë, istis'habi është dukuri prej dukurive të përgjithshme të shoqërisë, lindin dhe zhvillohen me shoqërinë, dhe do të mbetet sa mbesin ato shoqëri si garancion për të ruajtur sistemin dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë. Nëse shoqëritë janë në gjendje të heqin dorë nga istis'habi, sistemi i tyre nuk do të qëndronte. Shembull: Njeriu, udhëtari i cili lë familjen, qytetin dhe gjithë çka ka, nëse fillon të krijoj dyshime në atë çka ka lënë pas, krijon dyshime në mesin e udhëtarëve, dhe nuk i largon ato dyshime me ligjin e istis'habit, ai nuk do të mund të udhëtonte nga vendi i tij, por në esencë do të jetonte me vështirësitë në shtëpinë e tij dhe do të jetonte me dyshime në veprimet e shoqërisë ashtu që do të shkatërrohej sistemi shoqërorë në atë vend.

Unë i jap përparësi drejtimit të atyre të cilët deklarojnë për istis'habin si në vërtetim të çështjeve ashtu edhe në mohim të tyre, për shkak të fuqisë së argumenteve të tyre dhe për shkak të ngjarjeve të cilat paraqiten dhe kanë nevojë për istis'habin. Për këtë arsye Raziju ka thënë: **“Është i patjetërsueshëm në fe, në ligjësim dhe në traditë.”**

Rregullat e rezultuara prej istis'habit

Dijetarët kanë prodhuar disa rregulla të fikhut prej istis'habit, e ato janë:

1. Esenciale të mbetet çështja ashtu siç ka qenë deri sa të mos vërtetohet se është ndryshuar.

P.sh., te i humburi, esenciale është se ai është i gjallë deri sa të mos vërtetohet se ka vdekur, për këtë arsye dijetarët janë pajtuar se nuk trashëgohet, ndërsa çka trashëgon nga të tjerët, rezervohet për të deri sa të vërtetohet jeta e tij apo vdekja e tij, sipas shumicës absolute rezultimi i jetës së trashëguesit në momentin e vdekjes së trashëgimitarit, siç kemi sqaruar, te hanefijtë nuk trashëgon nga askush.

2. Te çështjet, esenciale është lejimi.

Bazuar në këtë, merret vendim për vlefshmërinë e kontratës ose shfrytëzimin e çështjes deri sa të silltet nga Ligjvënësi çka tregon për pavlefshmërinë apo prishjen e tij. Ashtu është edhe rregulli se për çdo

çështje përderisa nuk sillet argument prej teksteve të shariatit se ndalohet, ajo çështje është e lejuar, as nuk fajësohet vepruesi dhe as nuk penalizohet.

3. Esenciale në të drejta është paobligueshmëria.

Kjo kuptohet nga rregulli *istis'habi i lirisë*. Ky është rregull për të cilin janë pajtuar dijetarët. Nuk lejohet që një çështje t'i ngarkohet një personi ose të bashkëngjitet pos me argument, përderisa nuk ka nevojë për mohim (moskryerje apo mosveprim) pos me argument sepse kjo është bazë juridike për të cilën janë pajtuar.

4. E sigurt nuk anashkalohet me hamendje.

Kjo nënkupton se nuk hiqet ligji i saj me hamendje. Kush është i bindur se ka marrë abdes pastaj hamendet se mos e ka prishur, gjykohet se ai është me abdes. Kush dyshon në pastërtinë e ujit se mos është ndotur me pak ndyrësi apo me shumë. Esenciale është se ai ujë është i pastër.

Kush ha në mesnatë dhe dyshon në agimin e ditës, agjërimi i tij është i plotë sepse esenciale është nata, nata është e sigurt, ndërsa agimi i dyshimtë.

Kush ha në fund të ditës, pa bërë ndonjë hulumtim dhe dyshon në përfundimin e diellit agjërimi i tij prishet sepse esenciale është dita dhe dita është e sigurt ndërsa përfundimi i diellit i dyshimtë.

Vetëm se imam Maliku nuk e pranon vlefshmërinë e namazit me dyshimin se falësi ka qenë apo nuk ka qenë me abdes dhe obligohet me marrë abdes sepse edhe pse esenciale ka qenë abdesi (pastërtia) atëherë edhe namazi gjithashtu në esencë është detyrë. Nëse i thuhet (Malikut): Nuk del nga pastërtia (abdesi) me hamendësim. Imam Maliku përgjigjet: Nuk mund të hyhet në namaz me hamendësim, atëherë ai ka dalë nga pastërtia (abdes) me hamendësim.